

# ÇFARË ËSHTË PUSHTETI LOKAL DHE SI E ZGJEDHIM ATË

Doracak për zgjedhje  
lokale i dedikuar për  
votuesit





# ÇFARË ËSHTË PUSHTETI LOKAL DHE SI E ZGJEDHIM ATË

Doracak për zgjedhje lokale i  
dedikuar për votuesit



**Titulli:**

**Çfarë është pushteti lokal dhe si e zgjedhim atë - Doracak për zgjedhje lokale i dedikuar për votues**

**Autore dhe autorë:**

Nina Shulloviç-Cvetkovska, Maja Llazarova dhe Dushko Todoroski nga Misioni i OSBE-së në Shkup,

Admir Shabani dhe Ljupka Guguçevska-Filiposka nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor

**Botues:** Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup

**Titulli i origjinalit:** Што е локална власт и како ја избираме - Прирачник за локални избори наменет за гласачи

**Përktheu nga maqedonishtja në shqip:** Fatos Kica

**Lekturoi:** Ljuljeta Adili-Çeliku

**Përpunimi grafik dhe disenjimi:** Poliesterdej

Doracaku është përgatitur në kuadër të projektit "Mbështetje qeverisjes demokratike dhe proceseve inkluzive" të Misionit të OSBE-së në Shkup, në vitin 2021, në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Shkup

[www.osce.org/skopje](http://www.osce.org/skopje)

[www.sec.mk](http://www.sec.mk)



Republika e Maqedonisë së Veriut  
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mundet lirish të përdoret dhe shumëzohet për qëllime edukative dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që gjatë çdo riprodhimi të tillë si burim të ceken Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Misioni i OSBE-së në Shkup.

Përmbajtja, qëndrimet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e përfshira në këtë botim nuk reflektojnë këndvështrimet dhe qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

# Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| <b>HYRJE</b> . . . . .   | 5  |
| <b>1. VETËQEVERISJA LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT</b> . . . . .          | 7  |
| <b>2. ORGANET E KOMUNËS</b> . . . . .  | 9  |
| <b>3. ZGJEDHJET LOKALE – SI ZGJEDHEN ORGANET E KOMUNËS</b> . . . . .                   | 13 |
| 3.1. E drejta për të qenë e/i zgjedhur dhe e drejta e kandidimit . . . . .             | 13 |
| 3.2. Çfarë përmban një fletëvotim? . . . . .   | 15 |
| 3.3. Zgjedhja e kryetares/kryetarit të komunës . . . . .                               | 16 |
| 3.4. Zgjedhja e anëtarëve në këshillin komunal . . . . .                               | 17 |
| 3.5. Fushata zgjedhore dhe mediat . . . . .  | 18 |
| 3.6. Financimi i zgjedhjeve lokale . . . . .   | 19 |
| 3.7. Procedura e votimit . . . . .   | 20 |
| 3.8. Votimi i personave që kanë nevojë për ndihmë gjatë votimit . . . . .              | 22 |
| 3.9. Parashtrësia nga votues . . . . .   | 22 |
| <b>4. QEVERISJE DEMOKRATIKE</b> . . . . .  | 24 |
| 4.1. Çfarë paraqet qeverisja demokratike? . . . . .                                    | 24 |
| 4.2. Cilat janë parimet themelore të qeverisjes demokratike? . . . . .                 | 25 |
| <b>5. KOMPETENCAT E KOMUNËS</b> . . . . .  | 27 |
| 5.1. Cilat kompetenca i ka komuna? . . . . .   | 27 |
| 5.2. Mënyrat e ushtrimit të kompetencave . . . . .                                     | 29 |
| 5.3. Mbikëqyrja e punës së komunës . . . . .   | 29 |
| <b>6. FINANCIMI I KOMUNAVE</b> . . . . .   | 30 |
| <b>7. PJSËMARRJA E DREJTPËRDREJTË E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË KOMUNA</b> . . . . . | 32 |
| 7.1. Iniciativat qytetare . . . . .  | 32 |
| 7.2. Tubimet e qytetarëve . . . . .  | 32 |
| 7.3. Referendumi . . . . .   | 33 |
| 7.4. Parashtrësia dhe propozimet . . . . .   | 33 |
| 7.5. Tribunat publike, sondazhet dhe propozimet . . . . .                              | 34 |
| Literatura e përdorur: . . . . .   | 35 |



# HYRJE

Ky doracak u dedikohet të gjithë qytetareve dhe qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë dëshirë të njohtohen me termet bazë me të cilat do të ballafaqohen në vigjilie të zgjedhjeve lokale, si dhe me hapat në procesin zgjedhor.

Doracaku ofron shpjegim të shkurtë për atë se çka paraqet vetëqeverisja lokale, si dhe cilat organe zgjedhen në zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke përshkruar si zgjedhen organet e vetëqeverisjes lokale, doracaku në mënyrë praktike jep informacione çfarë përmban një fletëvotim, si zhvillohet procesi i votimit dhe kush i financon zgjedhjet lokale, ndërsa vështron edhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtës së votës.

Që lexuesit të kenë pasqyrë të plotë për kuptimin e pushtetit lokal në një shoqëri demokratike, në vazhdim është përshkruar se çfarë do të thotë qeverisja demokratike dhe cilat janë parimet themelore të qeverisjes demokratike. Duke u udhëhequr nga parimi se qytetare e qytetarë të informuar përbëjnë elementin kyç për funksionimin e suksesshëm të një shoqërie demokratike, doracaku ofron pasqyrën e kompetencave të komunave, gjegjësisht shpjegon në cilat segmente komunat ndikojnë në jetën e përditshme të banorëve të tyre. Mbikëqyrja e punës së komunave, financimi i komunave, si dhe metodat për përfshirje të drejtpërdrejtë të qytetareve dhe qytetarëve në marrjen e vendimeve në komunë janë kapitujt përmbyllës në këtë doracak.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, si organ më i lartë shtetëror përgjegjës për zbatimin e zgjedhjeve, është i përkushtuar që të gjithë votuesit të jenë të informuar mirë dhe në kohë lidhur me procesin zgjedhor dhe për të drejtat e tyre zgjedhore. Zgjedhjet janë element thelbësor i demokracisë dhe prandaj Komisioni

Shtetëror i Zgjedhjeve është i përkushtuar në ndërtimin e besimit të ndësjellë me opinionin publik. Besimi në organet që zbatojnë zgjedhjet, si dhe qytetare dhe qytetarë mirë të informuar, janë parakusht për zgjedhje demokratike, kredibile dhe të drejta.

Besojmë së doracaku do të jetë shumë i dobishëm për të gjithë votuesit e interesuar, ndërsa Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve gjithmonë është i hapur për të gjitha pyetjet, mendimet, këshillat dhe propozimet inovative.



# 1. VETËQEVERISJA LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre dhe përmbushjes së nevojave për shërbime lokale në jetën e përditshme, qytetarët në nivel lokal organizohen në njësi të vetëqeverisjes lokale. Kjo e drejtë për vetëqeverisje lokale qytetareve dhe qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut u garantohet me aktin më të lartë juridik të shtetit – Kushtetutën.

## Çka paraqet vetëqeverisja lokale?

Komuna është bashkësi e njerëzve që jetojnë në një territor të caktuar. Territori i komunës është i përcaktuar me ligj. Në kuadër të një komune, qytetarëve u mundësohet të kenë shërbime publike lokale, për të cilat kompetente është komuna si psh në: arsim, mbrojtje fëmijësh dhe mbrojtje të personave në moshë, shërbime komunale (ujësjellës, mbledhje dhe menaxhim i mbeturinave, mirëmbajtje e parqeve, sport, etj.). Që të mund të funksionojë dhe t'ua sigurojë shërbimet qytetareve dhe qytetarëve, komuna ka organe komunale, administratë komunale dhe shërbime të organizuara publike (ndërmarrje dhe institucione publike).

Komuna formohet në një territor me një ose më shumë vendbanime, ku qytetarët janë të lidhur ndërmjet vete me nevoja dhe interesa të përbashkëta. Interesat e qytetarëve dallojnë dhe në çdo vendbanim ka nevoja dhe prioritete të ndryshme. Nevojat në mjedise rurale dhe në ato urbane janë krejtësisht të ndryshme dhe për këtë arsye është e nevojshme që këtyre specifikave t'u jepet përgjigje përkatëse.

Organizimi territorial i Republikës dhe territoreve të komunës përcaktohet me ligj. Vetëqeverisja lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e organizuar në 80 komuna dhe Qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Territori ku formohet komuna duhet të paraqesë tërësi natyrore gjeografike dhe ekonomike, me komunikim ndërmjet vendbanimeve dhe gravitim kah një qendër të përbashkët – seli e komunës.

Në komunën e tyre, qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ofruar mendime dhe propozime personale ose përmes organeve përfaqësuese në komunë, vendosin për interesat dhe çështjet me interes lokal.


Organizimi i Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale përcaktohet me ligj të veçantë. Në Qytetin e Shkupit qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesëve marrin pjesë në marrjen e vendimeve për çështje të rëndësishme për qytetin. Në kuadër të Qytetit të Shkupit funksionojnë 10 komuna, të cilat kanë kompetenca të ndara me Qytetin.

## 2. ORGANET E KOMUNËS

Komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre përmes organeve të tyre. Ligji për vetëqeverisje lokale përcakton kompetencat e organeve të komunës.

**Organe të komunës janë: Këshilli dhe kryetarja/kryetari e/i komunës.**

Këshilli është organ përfaqësues i qytetarëve që vendos në kuadër të kompetencave të komunës. Është i përbërë nga anëtarë të cilët qytetarët, me votim të fshehtë, i zgjedhin në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira. Anëtarët e këshillit zgjidhen për mandat katërvjeçar.



Nga numri i banorëve në një komunë varet edhe numri i anëtarëve në këshillin komunal. Raporti i numrit të banorëve dhe numrit të këshilltarëve dhe këshilltareve në komuna paraqitet në Tabelën 1.

Tabela 1.

| MADHËSIA E KËSHILLAVE KOMUNALË |                              |
|--------------------------------|------------------------------|
| Numri i banorëve               | Numri i anëtarëve në Këshill |
| Deri 5.000                     | 9                            |
| Prej 5.001 deri në 10.000      | 11                           |
| Prej 10.001 deri në 20.000     | 15                           |
| Prej 20.001 deri në 40.000     | 19                           |
| Prej 40.001 deri në 60.000     | 23                           |
| Prej 60.001 deri në 80.000     | 27                           |
| Prej 80.001 deri në 100.000    | 31                           |
| Prej 100.000                   | 33                           |
| Qyteti i Shkupit               | 45                           |

*Burimi: Ligji për vetëqeverisja lokale, 2002*

Anëtarët e Këshillit janë të autorizuar t'i përfaqësojnë qytetarët, dhe në interesin e tyre, e me bindje personale, të marrin vendime në Këshill. Këshilli punon në seanca dhe merr vendime në pajtim me kompetencat e veta:

1. Miraton Statutin e komunës dhe akte tjera që parashohin rregullat e punës;
2. Miraton buxhetin e komunës dhe bilancin vjetor të komunës;
3. Vendos për lartësinë e burimeve vetanake të të ardhurave për financimin e komunës;
4. Themelon shërbime publike komunale (ndërmarrje/institucione) dhe mbikëqyr punën e tyre;
5. Emëron anëtarë në këshillat drejtues të ndërmarrjeve publike të cilat i themelon;
6. Miraton programe pune dhe plane financiare;
7. Miraton raportet financiare për realizimin e buxhetit dhe bilancin vjetor të komunës;
8. Miraton raportet e punës dhe bilancet vjetore të ndërmarrjeve publike që ka themeluar komuna;
9. Vendos për pronën në pronësi të komunës (shitje, qiradhënie);
10. Kryen kontroll financiar të buxhetit të komunës;

11. Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë së Punëve të Brendshme në komunë;
12. Shqyrton dhe miraton planin vjetor për siguri publike në territorin e komunës;
13. Të tjera.

Lidhur me shqyrtimin e çështjeve nga një fushë e caktuar, nga përbërja e tij Këshilli mund të formojë edhe komisione të përhershme dhe të përkohshme, si për shembull:

- Komision për financim, buxhet dhe zhvillim lokal ekonomik;
- Komision për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor;
- Komision për veprimtari shoqërore;
- Komision për Statut dhe rregullore;
- Komision për mundësi të barabarta të grave dhe burrave;
- Komision për të rinj dhe sport;
- Komision për mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Puna dhe vendimmarrja në Këshill duhet të zhvillohet duke respektuar parimet e funksionimit transparent, të hapur dhe me përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Kryetarja/kryetari e/i komunës paraqet organ ekzekutiv të komunës dhe ka këto kompetenca:

1. Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
2. Kontrollon nëse vendimet e Këshillit janë në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën;
3. Shpall vendimet dhe aktet e Këshillit në buletinin e komunës;
4. Kujdeset për ekzekutimin/realizimin e vendimeve të Këshillit;
5. I propozon Këshillit miratimin e akteve;
6. Propozon buxhetin vjetor dhe bilancin vjetor të komunës, të cilat i miraton Këshilli;
7. Realizon buxhetin e komunës;

8. Me konkurs publik, emëron drejtoresha dhe drejtorë në ndërmarrjet publike që ka themeluar komuna;
9. Udhëheq me administratën komunale;
10. Miraton rregullore për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale;
11. Vendos për punësimet, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, nëse me ligj nuk është e paraparë ndryshe;
12. Ia dorëzon Këshillit planin për punësime vjetore dhe pas miratimit ia dërgon Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë;
13. Siguron shfrytëzim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të drejtë dhe ligjore të pronës së komunës, në pajtim me ligjin dhe Statutin;
14. Të tjera.

Për ushtrimin e përgjegjësiave në kompetenca të organeve të komunës organizohet administratë komunale. Të punësuarit në administratën komunale janë kompetent të mbështesin organet komunale dhe në aspekt teknik të mundësojnë shërbime komunale në mënyrë të vazhdueshme.

Administrata komunale organizohet në njësi organizative – sektorë dhe departamente, dhe kryen këto detyra:

1. Kryen detyra kompetente për Këshillin dhe kryetaren/kryetarin e komunës;
2. Përgatit seancat e Këshillit, si dhe seancat e komisioneve të tij të përhershme dhe të përkohshme;
3. Udhëheq kontabilitetin e komunës;
4. Mbikëqyr punët nën kompetenca të komunës, si dhe inicon dhe propozon zgjidhje të problemeve lokale;
5. Dorëzon informacione dhe të dhëna lidhur me aktivitetet e komunës;
6. Të tjera.

Nëpunësit në administratën komunale janë pjesë e administratës publike, të punësuar me kontratë të përhershme. Ato nuk zgjedhen në zgjedhje të drejtëpërdrejta dhe nuk duhet të zëvendësohen pas zgjedhjes së kryetares së re/ kryetarit të ri të komunës ose këshillit të ri.

## 3. ZGJEDHJET LOKALE – SI ZGJEDHEN ORGANET E KOMUNËS

Organet e Njësive të vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht organet e komunës dhe qytetit të Shkupit zgjedhen në zgjedhje lokale. Në çdo komunë dhe në qytetin e Shkupit zgjidhet kryetare/kryetar komune dhe Këshilli Komunal ose Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Anëtarët e këshillave komunalë dhe kryetaret/kryetarët e komunave zgjedhen me votim të fshehtë në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira. Askush nuk guxon nga zgjedhësi të kërkojë përgjegjësi për votimin, e as të kërkojë nga ai/ ajo të tregojë se për kënd ka votuar.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet lokale mbahen çdo katër vite, në të njëjtën kohë në të gjitha 80 komunat dhe në qytetin e Shkupit.

Zgjedhjet e para lokale në vendin tonë, pas pavarësimit në vitin 1991, janë mbajtur në vitin 1996, e pastaj në vitin 2000, 2005, 2009, 2013, 2017 dhe zgjedhjet e radhës në vitin 2021.

Zgjedhjet i shpall Kryetari i Kuvendit me miratimin e aktit që shpallet në Gazetën Zyrtare. Zgjedhjet mbahen së paku 70 ditë, e më së voni 90 ditë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.

### 3.1. E drejta për të qenë e/i zgjedhur dhe e drejta e kandidimit

Kandidati/kandidatja për kryetare/kryetar komune ose anëtar këshilli mund të jetë shtetas, gjegjësisht shtetase i/e Republikës së Maqedonisë së Veriut që ka mbushur 18 vite, ka aftësi veprimi dhe ka banim të përhershëm në komunën ku kandidon. Personi që është dënuar me vendim gjyqësor fuqiptotë me dënim pa kusht me burg mbi 6 muaj, e që akoma nuk ka filluar ta kryejë dënimin ose kryen dënimin për vepër penale, nuk mund të kandidohet për këto funksione.

Propozimi i kandidatëve për kryetare dhe kryetar komune dhe anëtarë këshilli bëhet me dorëzimin e listave të kandidatëve për kryetare/kryetarë komune dhe listë kandidatësh për anëtarë këshilli. Listë të kandidatëve mund të dorëzojnë parti të regjistruara politike, koalicione të përbëra nga më shumë parti të regjistruara politike dhe grupe zgjedhësish. Ato quhen parashtrues të listave.

Nëse një grup zgjedhësish dëshiron të dorëzojë listë kandidatësh në zgjedhje lokale, ky grup së pari duhet të sigurojë një numër të caktuar nënshkrimesh nga qytetarë që përkrahin këtë listë. Numri i nënshkrimeve të cilat duhet të sigurohen varet nga numri i banorëve në komunë dhe fillon nga 100 nënshkrime për komunat më të vogla deri në 1000 nënshkrime për qytetin e Shkupit. Vetëm në këtë mënyrë lista e propozuar nga një grup zgjedhësish do të pranohet dhe do të mund të marrë pjesë në zgjedhje. Partitë e regjistruara politike dhe koalicionet nuk duhet të sigurojnë nënshkrime.

Listat e kandidatëve u dorëzohen organeve zgjedhore, në këtë rast komisioneve zgjedhore komunale dhe Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Shkupit, 35 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve. Organet zgjedhore verifikojnë nëse listat janë në pajtim me ligjin, çertifikojnë listat që plotësojnë kërkesat ligjore dhe i bëjnë ato publike në të gjitha vendbanimet dhe vendvotimet në komuna 23 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Një parashtrues liste (parti politike, koalicion ose grup zgjedhësish) në listën e kandidatëve mund të propozojë më së shumti aq kandidatë sa është numri i përgjithshëm i anëtarëve që mund të ketë këshilli në atë komunë (sipas Tabelës 1).

Për shembull në Këshillin e Komunës Qendër duhet të zgjidhen 23 anëtarë këshilli. Parashtruesi i listës A mund të propozojë më së shumti 23 kandidatë, mirëpo edhe parashtruesi i listës B poashtu mund të propozojë më së shumti 23 kandidatë këshilli, ndërsa për shembull parashtruesi i listës C mund të vendosë që të propozojë 10 kandidatë.

Në listat e kandidatëve për anëtarë të këshillit komunal dhe Qytetin e Shkupit, për tri pozicione të parapara së paku një pozicion duhet t'i takojë gjinisë më pak të përfaqësuar dhe përveç kësaj së paku nga një pozicion shtesë në çdo dhjetë pozicione të parapara. Në këtë mënyrë mundësohet që së paku 40% të kandidatëve të jenë të gjinisë më pak të përfaqësuar, e që në vendin tonë të shumtën e rasteve janë gratë.

Në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase, listat shpallen edhe në gjuhët zyrtare që përdoren në atë komunë.



Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i printon listat e çertifikuara të kandidatëve në formë fletëvotimesh për secilën komunë veç e veç. Gjatë votimit votuesëve u jepen nga dy fletëvotime: një për të votuar për kryetare/kryetar komune dhe një për të votuar për këshillin komunal, ndërsa votuesit nga Shkupi marrin edhe dy fletëvotime tjera, në të cilat votojnë për kryetaren/kryetarin e komunës së Qytetit të Shkupit dhe anëtarët e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

### 3.2. Çfarë përmban një fletëvotim?



Formën dhe përmbajtjen e fletëvotimit e përcakton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Fletëvotimet kanë shenja mbrojtëse të dukshme dhe të padukshme, që pamundësojnë keqpërdorimin e tyre. Ngjyra e sfondit të fletëvotimeve për kryetare/kryetar komune dhe të atyre për anëtarë këshilli dallojnë njëra me tjetrën. Në pjesën e epërme të fletëvotimit është i shënuar emri i komunës dhe numri i vendvotimit. Në vazhdim pason lista me emra të kandidatëve dhe partive politike, koalicioneve ose grupe zgjedhësish që kanë kandiduar. Në fletëvotimin për zgjedhje të kryetares/kryetarit të komunës janë shënuar emrat e kandidatëve

për kryetare/kryetar komune, ndërsa në fletëvotimin për anëtarë këshilli qëndrojnë emrat e bartësve të listave të kandidatëve. Në fletëvotim nuk janë shënuar emrat e të gjithë kandidatëve të propozuar për këshill. Siç u tha më lartë, ato lista janë bërë publike, ndërsa votuesi mund t'i shohë dhe lexojë në media ose të shpallura para vendvotimit ku realizon të drejtën e tij/saj për të votuar.

Votuesi voton në atë mënyrë që në fletëvotimin për kryetare/kryetar komune, gjegjësisht në fletëvotimin për këshill komunal me stilolaps të kaltër rrethon numrin rendor para emrit të kandidatit për të cilin dëshiron të votojë. Votuesi nuk është i obliguar që në të dy fletëvotimet të votojë për opsionin e njëjtë politik. Votimi është i fshehtë dhe çdo votues mund ta realizojë të drejtën e vetë të votës vetëm një herë.

Varësisht nga ajo se në cilën komunë jetojnë, votuesit kanë fletëvotime të printuara në gjuhën maqedonase ose në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në atë komunë. Madje, ka komuna ku fletëvotimet printohen edhe në dy apo tri gjuhë, për shembull në gjuhën maqedonase, rome dhe shqipe. Personat me shikim të kufizuar kanë në dispozicion shabllon me alfabetin e Brajlit.

### 3.3. Zgjedhja e kryetares/kryetarit të komunës

Zgjedhja e kryetares/kryetarit të komunës bëhet në territorin e një komune, gjegjësisht në territorin e qytetit të Shkupit, sipas parimit të shumicës. Parimi i shumicës nënkupton se kandidati që do të fitojë më së shumti vota, fiton mandatin zgjedhor.

Të drejtë vote kanë të gjithë qytetarët dhe qytetarët e moshës madhore me aftësi veprimi, që jetojnë në territorin e asaj komune dhe të cilët janë të regjistruar në listën zgjedhore. Votuesi nga emrat e shënuar në fletëvotim, zgjedh një kandidat nga kandidatët e çertifikuar për kryetare/kryetar komune.

#### Zgjedhjet për kryetare/kryetar komune mund të kenë një ose dy rrethe (cikle) votimi.

Nëse në rrethin e parë të votimit, në zgjedhje kanë dalur një e treta e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore për komunën përkatëse, për kryetare/kryetar komune zgjidhet ai/ajo kandidat/e që ka fituar më së shumti vota. Atëherë votimi në këtë komunë përfundon dhe nuk organizohet rreth i dytë.

Në ato komuna ku në rrethin e parë të votimit në zgjedhje kanë dalur më pak se një e treta e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore, organizohet rreth i dytë dhe të gjitha procedurat zgjedhore përsëriten.



#### FAKTE INTERESANTE:

Dalja në zgjedhje lokale të mbajtura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 1996 deri në vitin 2017, për rrethin e parë dhe të dytë<sup>1</sup>:

| VITI                 | 1996 | 2000 | 2005 | 2009 | 2013 | 2017 |
|----------------------|------|------|------|------|------|------|
| <b>Rrethi i parë</b> | 60%  | 59%  | 56%  | 57%  | 67%  | 60%  |
| <b>Rrethi i dytë</b> | 51%  | 53%  | 53%  | 43%  | 65%  | 52%  |

Rrethi i dytë mbahet në afat prej 14 ditësh nga dita e përfundimit të rrethit të parë. Në rrethin e dytë zgjedhet ndërmjet dy kandidatëve të cilët në rrethin e parë kanë marrë më së shumti vota. Emrat e kandidatëve tjerë që kanë qenë në listën e parë, e që kanë marrë më pak vota, nuk do të jenë më në fletëvotim. Zgjedhet ai kandidat që në rrethin e dytë ka fituar numër më të madh të votave.

<sup>1</sup> Burimi: Raporti i Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale në vitin 2017 dhe Doracaku për zgjedhjet lokale në vitin 2017 nga Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup.

Nëse edhe në rrethin e dytë për çfarëdo arsye nuk zgjedhet kryetare/kryetar komune, Qeveria emëron ushtrues/e detyre që do të kryejë kompetencat e kryetares/kryetarit të komunës, derisa në atë komunë sërish të shpallen zgjedhje dhe të organizohen përsëri zgjedhje për kryetare/kryetar komune.

### **3.4. Zgjedhja e anëtarëve në këshillin komunal**

Zgjedhja e anëtarëve në këshillin komunal bëhet në territorin e komunës, gjegjësisht në territorin e qytetit të Shkupit, sipas modelit proporcional me lista të mbyllura. Listë e mbyllur nënkupton që votuesi voton për një listë kandidatësh, ashtu siç është propozuar ajo listë nga parashtruesi i saj. Modeli proporcional parasheh që pas përfundimit të votimit dhe numërimit të votave, shpërndarja e mandateve të bëhet ndërmjet parashtruesve të listave, sipas një modeli matematikor saktë të përcaktuar dhe në proporcion me rezultatet zgjedhore.

Të drejtë vote kanë të gjithë qytetarët e moshës madhore me aftësi veprimi, që jetojnë në territorin e asaj komune dhe që janë të regjistruar në listën zgjedhore. Sipas bindjeve personale votuesi rrethon vetëm një listë kandidatësh, të propozuar nga një parashtrues liste (parti e caktuar politike, koalicion ose grup zgjedhësish). Në këtë mënyrë votuesi nuk e jep votën e vet për secilën këshilltare/secilin këshilltar veç e veç, por për një opcion të caktuar politik (parti, koalicion, grup të kandidatëve të pavarur).

Përlllogaritja se sa këshilltare dhe këshilltarë do të ketë një parti e caktuar politike ose koalicion në këshillin e komunës bëhet sipas së ashtuquajturës formulë të D'Hondt-it, duke marrë parasysh numrin e votave që ka fituar lista e propozuar e asaj partie politike ose atij koalicioni në zgjedhje.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit zhvillohet vetëm në një rreth votimi.

Pas përfundimit të zgjedhjeve dhe çertifikimit të rezultateve përfundimtare, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka gjithsej 81 kryetare/kryetarë komunash dhe 81 këshilla komunalë, që do të kenë mandat në katër vitet e ardhshme.

Funksioni i kryetares/kryetarit të komunës është funksion profesional. Kjo nënkupton se kryetarja/kryetari e/i komunës gjatë mandatit të vet ndalon angazhimin e saj/tij në vendin paraprak të punës dhe kryen funksionin e kryetares/kryetarit të komunës me orar të plotë, për të cilën merr rrogë të rregullt mujore. Ndërkaq, anëtarët e këshillit vazhdojnë me punë në vendet e tyre aktuale të punës, ndërsa funksionin e këshilltares/këshilltarit e kryejnë në mënyrë plotësuese dhe për këtë marrin një kompenzim të caktuar financiar të përcaktuar me ligj.

Personi që është zgjedhur dhe që ka pranuar funksionin e kryetares/kryetarit të komunës ose anëtar këshilli, në të njëjtën kohë nuk mund të kryejë funksione tjera publike siç janë: kryetare/kryetar e/i Republikës, deputete/deputet në Kuvend, kryetare/kryetar kuvendi, ministre/ministër, zëvendës-ministre/zëvendës-ministër, gjykatëse/gjykatës, prokurore publike/prokuror publik, avokate publike/avokat publik, avokate/avokat populli dhe funksione tjera të cilat i zgjedh ose emëron Kuvendi dhe Qeveria, anëtar këshilli drejtues në ndërmarrje publike, ent, fond, agjenci ose ngjashëm. Poashtu, kryetarja/kryetari e/i komunës nuk mund në të njëjtën kohë të jetë edhe anëtare/anëtar këshilli komunal dhe e kundërta.



## FAKTE INTERESANTE:

Në zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2017, 19 parti politike dhe koalicione dhe 65 grupe votuesish propozuan gjithsej 258 kandidatë për kryetare dhe kryetarë komune dhe 370 lista për këshilla komunalë. U zgjodhën 81 kryetare/kryetarë komune dhe gjithsej 1.347 anëtarë në 81 këshilla komunalë. Rrethi i parë u mbajt më 15 tetor 2017, kur u zgjodhën 45 kryetare dhe kryetarë komunash, ndërsa rrethi i dytë u mbajt më 29 tetor dhe atëherë u zgjodhën kryetare dhe kryetarë për 35 komunat e mbetura. Nga 81 kandidatët e zgjedhur, vetëm 6 ishin gra. Votimi në rrethin e parë është zhvilluar në 3.478 vendvotime në territorin e gjithë vendit, ndërsa të drejtë vote kanë pasur 1.814.644 qytetarë të regjistruar në listën zgjedhore. Zgjedhjet i kanë vëzhguar 6.417 vëzhgues ndërkombëtarë dhe të vendit.<sup>2</sup>

### 3.5. Fushata zgjedhore dhe mediat

Fushata zgjedhore paraqet prezentim publik të kandidatëve që marrin pjesë në garën zgjedhore dhe programeve të tyre, përmes takimeve publike, ngjarjeve, ngjitjes së afisheve, video-prezetimeve publike, shpërndarjes së materialeve të printuara dhe prezentimit në media. Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Domethënë, një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve nuk lejohet fushatë zgjedhore dhe transmetim i saj. Këtë e quajmë **heshtje zgjedhore**. Mirëpo, ditën e zgjedhjeve, gjegjësisht gjatë heshtjes zgjedhore, mediave u lejohet të raportojnë (dhe ato gjithsesi e bëjnë këtë!) për rrjedhën e procesit zgjedhor dhe për votimin.

<sup>2</sup> "Raporti për zgjedhje lokale 2017", Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, 30.10.2017, është në dispozicion si vijon: <https://drive.google.com/file/d/1TikLdNzuV-pABg12HX4okeu2fj1lXF-F/view>

Mediat e shtypura, shërbimi radio-difuziv publik (Radio-Televizioni Maqedonas – RTM), televizionet dhe radiot nacionale private, si dhe internet portalet që kanë vendosur ta mbulojnë procesin zgjedhor, e kanë për obligim ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe objektive. Pavarësisht gjuhës në të cilën emitojnë, ato e kanë për detyrë të gjithë kandidatëve t'u mundësojnë qasje të barabartë në të gjitha emisionet dhe format e paraqitjes mediale. RTM dhe televizionet dhe radiot nacionale poashtu e kanë për detyrë që informatat lidhur me zgjedhjet t'i emitojnë në formate që janë të kapshme për të gjithë qytetarët, si dhe në gjuhën e simboleve.

Programet e dedikuara për publikun e mitur nuk guxojnë të shfrytëzohen për prezantim medial zgjedhor.

### 3.6. Financimi i zgjedhjeve lokale

Mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve lokale sigurohen nga buxheti i komunës dhe Qytetit të Shkupit. Me ato disponon komisioni zgjedhor komunal, gjegjësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit. Mjetet e nevojshme për materialin zgjedhor (kuti votimi, paravanë, fletëvotime, material informativ etj.) sigurohen nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ato disponon Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.

Nëse një komunë nuk ka mundësi t'i sigurojë mjetet për zbatimin e zgjedhjeve lokale për shkak të llogarisë së bllokuar, atëherë ato sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për dallim nga zgjedhjet lokale për organizimin e të cilave mjetet sigurohen nga buxheti i komunës, fushata zgjedhore nuk guxon të financohet nga mjete publike, siç janë: buxhetet e komunave dhe mjete nga ndërmarrje publike, institucione, shoqata të qytetarëve, bashkësi fetare, grupe religjioze dhe fondacione, qeveri të huaja, organizata ndërkombëtare dhe ngjashëm.

Një parti politike fushatën e vet zgjedhore mund ta financojë nga mjete financiare me të cilat disponon kjo parti politike, donacione që pranon partia dhe kredi të dedikuara për zgjedhje.

Pas përfundimit të zgjedhjeve të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (partitë politike, koalicionet dhe grupet zgjedhore, mediat dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve) e kanë për detyrë që organeve kompetente t'u dorëzojnë raport financiar.

Pasi që organet kompetente të kenë publikuar rezultatet zyrtare dhe përfundimtare zgjedhore, përfaqësuesit e zgjedhur, gjegjësisht kryetaret/kryetarët e komu-

nave dhe këshillat komunalë fillojnë të ushtrojnë detyrat e tyre në kuadër të kompetencave të komunës, të mbështetur nga administrata komunale.

### 3.7. Procedura e votimit

Votimi mbahet në ditën e caktuar për votim, në pajtim me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve lokale, të cilën e miraton Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Votimi fillon në ora 07:00 dhe vazhdon pa ndërpreje deri në ora 19:00.

Të drejtë vote ka secili person që:

- » është i regjistruar në ekstraktin e listës zgjedhore dhe
- » posedon dokument të vlefshëm për identifikim personal – letërnjoftim ose pasaportë.

Procedura e votimit zhvillohet siç vijon:

- » Votuesit presin në radhë për të votuar njëri pas tjetrit;
- » Këshilli Zgjedhor do ta kontrollojë identitetin personal të votuesit;
- » Identiteti personal verifikohet me një dokument personal të vlefshëm dhe një gjurmë gishtash. Një dokument identiteti i vlefshëm konsiderohet të jetë: një letërnjoftim i vlefshëm ose një pasaportë ose një letërnjoftim, vlefshmëria e së cilës ka skaduar në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre
- » Votuesi nuk do të jetë në gjendje të votojë nëse nuk ka një nga dokumentet personale të mësipërme të vlefshme ose nëse gjurmët e gishtave nuk përputhen me gjurmët e gishtave në listën elektronike zgjedhore, pa marrë parasysh nëse qëndron i evidentuar në listën zgjedhore;
- » Këshilli Zgjedhor kryen kontrollin nëse votuesi ka votuar paraprakisht;
- » Verifikimi i identitetit dhe kontrolli nëse votuesi ka votuar paraprakisht, bëhet në atë mënyrë që votuesit do t'i merret gjurmë nga gishti tregues i dorës së djathtë. Nëse votuesi nuk ka gisht tregues në dorën e djathtë, merret gjurmë nga gishti tregues i dorës së majtë. Nëse votuesit i mungojnë këto dy gishta, merret gjurmë nga gishti i radhës;

- » Në ekranin e monitorit do të paraqitet fotografia e votuesit dhe numri rendor në listën zgjedhore, e pas kësaj votuesi do të nënshkruhet në listën zgjedhore;
- » Pas përfundimit të kësaj procedure, votuesit do t'i jepen fletëvotimet, një për zgjedhje të kryetares/kryetarit të komunës dhe një fletëvotim për zgjedhjen e këshilltarëve dhe këshilltareve në këshillin komunal, me ç'rast në vendin e paraparë për vulë, fletëvotimet vulosen me vulën e vendvotimit;
- » Votohet personalisht pas paravanit, duke rrethuar numrin rendor para vetëm një kandidati me stilolapsin e vendosur brenda në paravan;
- » Rrethimi i më shumë kandidatëve, shënimit të simboleve shtesë, të shkruarit anash fletëvotimit ose shënimi i fletëvotimit me fllomaster ose stilolaps në çfarëdo ngjyre përveç ngjyrës së kaltër, e bëjnë atë fletëvotim – të pavlefshëm;
- » Pasi që të ketë votuar, votuesi palos secilin fletëvotim veç e veç dhe e fut në kutinë përkatëse të votimit;
- » Merret dokumenti për identifikim personal dhe largohet nga vendvotimi.

**Përjashtimi ekziston** kur pajisja teknike nuk mund të gjejë përputhje të gjurmëve, ndërsa këshilli zgjedhor mund ta verifikojë identitetin e votuesit përmes letërnjoftimit të vlefshëm ose pasaportës së vlefshme dhe nga nënshkrimet në listën zgjedhore do të konstatojë se nuk ka votuar paraprakisht – atëherë në pajisjen teknike do të shënohet numri amë i qytetarit (NAQ) dhe do t'i merret gjurmë gishti, me qëllim të ushtrimit të së drejtës zgjedhore.

Verifikimi i identitetit të votuesit dhe kontrolli nëse ai/ajo ka votuar paraprakisht, bëhet pa pajisje teknike në këto raste:

- » për votim të zgjedhësve që votojnë në shtëpi,
- » për votim të qytetarëve që gjatë zgjedhjeve gjenden në institucione për kujdes jashtëfamiljar,
- » për votim të qytetarëve që gjatë zgjedhjeve kryejnë dënim me burg ose janë në paraburgim ose arrest shtëpiak,
- » kur votojnë qytetarë që gjatë zgjedhjeve kanë punë të përkohshme ose qëndrim të përkohshëm jashtë shtetit,
- » për votimin e anëtarëve të këshillave zgjedhorë për votim në përfaqësitë diplomatike-konzulare, gjegjësisht zyrat konzulare.

### 3.8. Votimi i personave që kanë nevojë për ndihmë gjatë votimit

Këshilli Zgjedhor është i obliguar që personave me aftësi të kufizuar, të cilët nuk mund të hyjnë ose të kenë qasje në vendvotim, t'u mundësojë që në mënyrë të përshtatshme të hyjnë, gjegjësisht të kenë qasje në vendvotim, për të ushtruar të drejtën e tyre të votës.

Nëse këta persona nuk janë të shoqëruar nga një person i cili do t'i ndihmojë ata në hyrje ose gjatë qasjes në qendrën e votimit, atëherë Këshilli Zgjedhor është i detyruar të caktojë persona nga radhët e votuesve që në atë moment janë të pranishëm në vendvotim, për të ndihmuar votuesin me aftësi të kufizuar të hyjë në qendrën e votimit, për të ushtruar të drejtën e tij/saj të votës.

**ME RËNDËSI:** Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në bashkëpunim me shoqatat qytetare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, përgatit materiale që personave me aftësi të kufizuar u mundësojnë qasje më të lehtë në procesin zgjedhor (p.sh. duke përcaktuar kufij orientues për nënshkrim në listën e zgjedhësve, shabllone në alfabetin e Brajlit, posterë me ilustrime të hapave për votim, të vendosura përpara secilit anëtar të KZ-së dhe materiale tjera).

### 3.9. Parashtrësia nga votues

Nëse për ndonjë arsye një zgjedhës nuk lejohet të ushtrojë të drejtën e tij/saj të votës, Këshilli Zgjedhor, me kërkesë të zgjedhësit, duhet të plotësojë një formular në dy kopje, të miratuar më parë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në të cilin do të shënojë dhe shpjegojë arsyet për këtë dhe një kopje duhet t'ia japë votuesit.

Këshilli Zgjedhor:

- » Votuesin duhet ta udhëzojë që t'i drejtohet Komisioni Zgjedhor Komunal (KZK).

**Ditën e votimit KZK është e hapur për të gjithë votuesit që kërkojnë ndihmë për të ushtruar të drejtën e tyre të votimit.**

**Secili votues ka të drejtë që në Komisionin Zgjedhor Komunal të dorëzojë:**

- » **parashtrësë për mbrojtje të së drejtës personale zgjedhore në procedurë votimi** (KZK e ka për detyrë që secilit votues që do t'i drejtohet KZK-së për të parashtruar ankesë, t'i dorëzojë formular me të cilin do ta paraqesë parashtrësën); dhe



- » **ankesë për shkak të shkeljes së të drejtës së votës personale në secilën fazë të procesit zgjedhor, që secili votues mund t'ia drejtojë Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve drejtpërdrejt ose përmes Komisionit Zgjedhor Komunal brenda 12 orëve . (KZK është e detyruar të lëshojë një formular ankesë për secilin votues që i drejtohet KZK-së me qëllim të paraqitjes së ankesës, ose ta udhëzojë dhe ta ndihmojë atë për ta plotësuar formularin elektronik të ankesës në [www.prigovori.sec.mk](http://www.prigovori.sec.mk))**

## 4. QEVERISJE DEMOKRATIKE

### 4.1. Çfarë paraqet qeverisja demokratike?

Si duhet të punojnë komunitatet? Cilat parime punë duhet t'i respektojnë organet komunale gjatë ushtrimit të detyrave të tyre?

Demokracia nënkupton qeverisjen ku të gjithë qytetarët dhe qytetarët e moshës madhore e ushtrojnë fuqinë dhe përgjegjësinë qytetare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte përmes përfaqësuesve dhe përfaqësuesëve të tyre, të zgjedhur në mënyrë të lirë në zgjedhje korrekte dhe demokratike.

### Çka është demokracia dhe si janë shoqëritë demokratike?

- Demokracia bazohet në parimin e qeverisjes së shumicës, që nënkupton se vendimet që sjell shumica duhet të pranohen nga të gjithë, por duhet të respektohen edhe qëndrimet e pakicës;
- Në shoqëritë demokratike pushteti qendror përcaktohet për decentralizim, respektivisht transferim të kompetencave dhe të drejtën për menaxhimin me financat lokale (arkëtimit dhe realizim) në nivel lokal, sepse problemet lokale më mirë zgjidhen në nivel lokal;
- Në shoqëritë demokratike qytetarët dhe qytetarët kanë të drejta dhe përgjegjësi të marrin pjesë në jetën politike.

Sipas Kushtetutës, Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet sovran dhe i pavarur, qytetar dhe demokratik. Në të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë qytetare, vendoset sundimi i së drejtës si sistem themelor i qeverisë dhe sigurohet drejtësi sociale, mirëqenie ekonomike dhe progres i jetës personale dhe jetës në bashkësi. Në këtë drejtim aspiron edhe vendi – drejt zhvillimit të demokracisë dhe respektimit të parimeve demokratike të qeverisjes.

#### 4.2. Cilat janë parimet themelore të qeverisjes demokratike?

1. **Të drejtat e njeriut:** në shoqëritë demokratike, shteti dhe institucionet synojnë t'i mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetareve dhe qytetarëve të tyre nga çdo keqpërdorim; disa nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut janë: e drejta e jetës, ndalimi i torturës, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë dhe korrekt, e drejta për jetë private dhe familjare, e drejta për mbrojtje shëndetësore, ndalimi i diskriminimit, dhe të tjera;
2. **Barazia:** barazia e gjithë qytetareve dhe qytetarëve do të thotë që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të njëjta në realizimin e kapaciteteve dhe të drejtave individuale pa dallim race, gjinie, përkatësie etnike, feje dhe ngjashëm;
3. **Zgjedhjet korrekte dhe të lira:** zgjedhjet e lira dhe korrekte u japin qytetareve dhe qytetarëve mundësinë që sipas vullnetit të tyre të lirë, vetë t'i zgjedhin liderët e tyre;
4. **Sundimi i së drejtës:** ligjet duhet të vlejnjë njësoj për të gjithë qytetarët dhe qytetarët; të gjithë duhet t'i respektojnë ligjet dhe t'u nënshtrohen dënimeve, nëse veprojnë në kundërshtim me ligjet;
5. **Sundimi i së drejtës:** ligjet duhet të vlejnjë njësoj për të gjithë qytetarët dhe qytetarët; të gjithë duhet t'i respektojnë ligjet dhe t'u nënshtrohen dënimeve, nëse veprojnë në kundërshtim me ligjet;
6. **Sistemi shumëpartiak:** ekzistimi i më shumë partive mundëson zgjedhje më të madhe, dhe qytetarët dhe qytetarët të mund të zgjedhin për liderë të tyre kandidatët më të mirë për funksione të caktuara politike;
7. **Toleranca politike:** shumica qeverisëse/partitë në pushtet punojnë për realizimin e programit të tyre, për çka kanë marrë mandatin nga qytetarët dhe qytetarët në zgjedhje, por duhet t'i respektojnë edhe interesat e pakicës/partive që nuk janë në koalicion qeveritar;
8. **Neutraliteti i institucioneve shtetërore:** institucionet shtetërore dhe funksionarët publikë duhet të punojnë në mënyrë profesionale dhe të paanshme, duhet të jenë neutralë dhe mos përfaqësojnë interesat e një partie të caktuar politike ose partive në pushtet; puna profesionale dhe objektive do të kontribuojë për përmbushje cilësore të nevojave dhe cilësi më të mirë të jetës së qytetareve dhe qytetarëve;

9. **Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes:** qytetarët dhe qytetarët zgjedhin lideret dhe liderët e tyre në zgjedhje, në bazë të programit që kandidatët e ndryshëm e prezantojnë para zgjedhjeve, mirëpo, përfaqësueset dhe përfaqësuesit e zgjedhur e kanë për obligim t'u mundësojnë qytetareve dhe qytetarëve që gjatë mandatit të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë të marrin pjesë në vendimmarrje për çështje të rëndësishme lokale, përmes formave të pjesëmarrjes, si iniciativa qytetare, tubime qytetarësh dhe referendumit; komunikimi mes komunës dhe qytetarëve duhet të jetë proces dykahësh, konsultativ – nga poshtë lart dhe nga lart poshtë, para se të merren vendimet lokale;
10. **Transparenca:** funksionarët publikë mundësojnë shqyrtim publik të asaj që bëjnë deri sa janë në funksion publik, duke lejuar që qytetarët dhe qytetarët të marrin pjesë në debatet publike dhe të informohen;
11. **Llogaridhënia:** lideret dhe liderët e zgjedhur ose nëpunësit publikë e marrin pushtetin e tyre nga qytetarët dhe qytetarët; rrjedhimisht janë të detyruar që rregullisht dhe në kohë të informojnë për vendimet e tyre dhe rezultatet e punës së tyre;
12. **Kontrolli mbi keqpërdorimin e fuqisë:** pa ekzistimin e kontrollit mbi kompetencat e saj, secila qeveri mund t'i keqpërdorë ato – mund të ndodhë që te persona qeveritarë interesi privat të mbizotërojë mbi interesin publik të qytetarëve, për të cilën duhet të dënohen dhe të japin përgjegjësi;
13. **Liria ekonomike** paraqet aftësinë e njerëzve dhe shoqërisë të ndërmarrin aktivitete ekonomike. Qytetarët dhe qytetarët më të varfër më lehtë u ekspozohen keqpërdorimeve të ndryshme për qëllime politike, sepse u mungojnë mjete financiare për të plotësuar nevojat e tyre themelore të jetës. Si rezultat i këtyre rrethanave, ndodh që ata në kohë zgjedhjesh të pranojnë rryshfet. Pasojat nga kjo nuk janë të vulltshme, si për shembull në pushtet mbesin liderë të korruptuar.

# 5. KOMPETENCAT E KOMUNËS

## 5.1. Cilat kompetenca i ka komuna?

Krahas pushtetit qendror, një numër i madh shërbimesh për qytetarët dhe qytetarët sigurohen nga komunat. Në territorin e vet, komunat i kryejnë punët që janë me interes publik dhe me rëndësi lokale. Sipas ligjit, komunat në mënyrë të pavarur organizojnë dhe kryejnë veprimtaritë në vijim:

1. **Planifikimin urbanistik (urban dhe rural)** – japin lejet për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale, rregullojnë hapësirën dhe tokën ndërtimore;
2. **Mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës** – ndërmarrin masa për mbrojtje dhe parandalim të ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtje nga zhurma dhe nga rrezatimi jo-jonizues;
3. **Zhvillimin ekonomik lokal** – planifikojnë zhvillimin ekonomik lokal; përcaktojnë prioritetet zhvillimore; udhëheqin politikën ekonomike lokale; mbështesin zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të sipërmarrësisë në nivel lokal, marrin pjesë në formimin dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjencive, si dhe promovojnë partneritetin;
4. **Veprimtaritë komunale** – sigurojnë ujë të pijshëm; sigurojnë ujin teknologjik; largojnë dhe filtrojnë ujërat e zeza; sigurojnë ndriçimin publik; largojnë dhe trajtojnë ujërat atmosferikë; mirëmbajnë pastërtinë publike; mbledhin, transportojnë dhe trajtojnë mbeturinat; rregullojnë dhe organizojnë transportin publik lokal të udhëtarëve; furnizojnë gaz natyror dhe energji për ngrohje; mirëmbajnë varret, varrezat, krematoriumet dhe ofrojnë shërbime mortore; ndërtojnë, mirëmbajnë, rekonstruojnë dhe kujdesen për rrugicat lokale, rrugët dhe objektet tjera infrastrukturore; rregullojnë regjimin e trafikut; ndërtojnë dhe mirëmbajnë sinjalizimin e trafikut rrugor; ndërtojnë dhe mirëmbajnë hapësirat publike për parkim; largojnë automjetet e parkuara gabimisht; largojnë automjetet e djegur nga hapësirat publike; ndërtojnë dhe mirëmbajnë tregjet;

pastrojnë oxhaqet; mirëmbajnë dhe menaxhojnë parqet, gjelbërimet, pyjet dhe hapësirat rekreative; rregullojnë, mirëmbajnë dhe menaxhojnë shfrytëzimin e shtretërve të lumenjëve në pjesët urbane; vendosin emrat e rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukturore;

5. **Kulturën** – mbështesin institucionalisht dhe financiarisht institucione dhe projekte kulturore; përkujdesen për folklorin, traditat, zejet e vjetra dhe vlera të ngjashme kulturore; organizojnë manifestime kulturore; nxisin forma të llojllojshme të krijimtarisë;
6. **Sportin dhe rekreimin** – zhvillojnë sportin masiv dhe aktivitetet rekreative; organizojnë shfaqje dhe manifestime sportive; mirëmbajnë dhe ndërtojnë objekte sportive; mbështesin federatat e sportit;
7. **Mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve** – kopshte fëmijësh dhe azile për pleq (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje); sigurojnë përkujdes social për personat me aftësi të kufizuar, fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror; kujdesen për fëmijët me probleme edukative-sociale; për fëmijët me nevoja të veçanta; për fëmijët nga familje me një prind; për fëmijët në rrugë; për personat e ekspozuar në rrezik social; për personat që abuzojnë me drogë dhe alkool; ngrisin vetëdijen e popullatës; strehojnë personat me rrezik shoqëror; realizojnë të drejtën dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore;
8. **Arsimin** – themelojnë, financojnë dhe administrojnë shkollat fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror; organizojnë transportin dhe ushqimin për fëmijët, si dhe vendosjen e tyre në konvikte për nxënës;
9. **Mbrojtjen shëndetësore** – menaxhojnë me rrjetin e organizatave dhe objekteve shëndetësore publike të mbrojtjes primare shëndetësore, që duhet të përfshijnë përfaqësim të vetëqeverisjes lokale në të gjitha këshillat drejtues e të gjitha organizatave shëndetësore në pronë publike, edukimin shëndetësor; avancojnë shëndetin; ndërmarrin aktivitete parandaluese; mbrojnë shëndetin e punëtorëve dhe sigurojnë mbrojtje në punë; sigurojnë mbikëqyrje shëndetësore të mjedisit jetësor; mbikëqyrin sëmundjet ngjitëse; ndihmojnë pacientët me nevoja speciale (për shembull, lidhur me shëndetin mendor, abuzimin me fëmijë etj.) dhe fusha tjera;
10. **Përgatitjen dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale** nga shkatërrimet e luftës, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, si dhe pasojat e shkaktuara nga to;
11. **Mbrojtjen kundër zjarrit** që bëhet nga njësitë territoriale zjarrfikëse;

12. **Mbikëqyrjen dhe kontrollin** mbi kryerjen e detyrave në kompetenca të komunës; dhe
13. Veprimtari tjera të parapara me ligj.

## 5.2. Mënyrat e ushtrimit të kompetencave

Me qëllim të ushtrimit të kompetencave të tyre, komunat mund të themelojnë shërbime publike, gjegjësisht ndërmarrje publike (për shembull ndërmarrje komunale për ujësjellës) dhe institucione publike (për shembull, shtëpi kulture). Ndërsa për kompetenca të caktuara dy ose më shumë komuna mund të vendosin bashkëpunim ndërkomunal, gjegjësisht t'i bashkojnë resurset dhe bashkarisht t'i ushtrojnë kompetencat për të cilat ekziston nevoja në të gjitha komunat që janë pjesë e bashkëpunimit (për shembull, shërbime të përbashkëta inspektoriale, ndërmarrje të përbashkëta komunale etj.).

Në mënyrë plotësuese, për kryerjen e kompetencave të caktuara, komuna mund të bashkëpunojë edhe me shoqata qytetare dhe organizata tjera. Bashkëpunimi mund të vendoset përmes thirrjes publike nga komuna për një fushë konkrete dhe kryerjen e punëve të definuara për të cilat aplikojnë shoqatat qytetare, apo thirrje ku shoqatat mund të aplikojnë me ide personale për atë se si të tejkalohen problemet e detektuar në bashkësinë lokale. Komunat poashtu mund të sigurojnë mbështetje për aktivitete rrjedhëse të shoqatave ose organizatave që kanë rol specifik në bashkësinë lokale, siç janë kujdesi për personat me aftësi të kufizuara, arsimi joformal, klubet dhe federatat e sporteve etj.

## 5.3. Mbikëqyrja e punës së komunës

Puna e komunës mbikëqyret rregullisht, e kjo ka të bëjë me mbikëqyrjen e ligjshmërisë, si dhe me kontrollin dhe revizionin e punës materiale dhe financiare.

1. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve dhe rregulloreve të komunës e bën Ministria për Vetëqeverisje Lokale.
2. Mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së organeve të komunës e bën Inspektoriati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale.
3. Kontrollin e punës materiale dhe financiare të komunës e bën Ministria e Financave.

Çdo qytetar ka të drejtë, individualisht ose bashkarisht me të tjerë, të dorëzojë parashtrësia dhe propozime për punën e organeve të komunës dhe administratës komunale. Kryetarja/kryetari e/i komunës e ka për detyrë që më së voni 60 ditë nga dita e pranimit të parashtrësës ose propozimit, t'i përgjigjet parashtruesit.

## 6. FINANCIMI I KOMUNAVE

Që komunat të munden t'i kryejnë obligimet dhe të sigurojnë shërbime për qytetaret dhe qytetarët e tyre, ato duhet të kenë në dispozicion mjete financiare të mjaftueshme. Mënyra e financimit të komunave është paraparë me Ligjin për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale, Ligjin për Qytetin e Shkupit, Ligjin për tatimin në pronë, Ligjin për taksa komunale dhe administrative, etj. Sipas dispozitave ligjore, komunat i sigurojnë mjetet financiare nga tri burime kryesore të të ardhurave, si më poshtë:

**A. Të ardhura vetanake** – komuna vetë mbledh dhe arkëton nga taksapaguesit e saj (persona fizikë dhe juridikë):

- » tatime lokale (tatime në pronë),
- » kompenzime lokale (rregullimi i tokës ndërtimore, etj.),
- » taksa lokale (komunale, administrative),
- » të ardhura tjera vetanake (dënime lokale, vetëkontribute, të ardhura nga prona, etj.).

Këshilli i komunës me vendim përcakton lartësinë e shkallës së tatimeve dhe lartësinë e kompenzimeve dhe taksave.

**B. Transfere dhe dotacione** – komuna i pranon nga buxheti qendror:

- » të ardhura nga tatimi i vlerës së shtuar (një pjesë e të ardhurave të mbledhura në buxhetin qendror u transferohen buxheteve komunale),
- » dotacione të destinuara (për qëllim të caktuar),
- » bllok-dotacione (arsim, kopshte fëmijësh, kulturë),
- » dotacione kapitale (projekte kapitale).

**B. Huamarrje**

- » Hua/kredi,
- » Dhënie e letrave komunale me vlerë.



Këshilli i komunës duhet ta miratojë huamarrjen afatgjate, në bazë të debatit paraprak publik – konsultimit me banorët e komunës.

Buxheti është dokumenti më i rëndësishëm që miraton këshilli i komunës gjatë një viti, në bazë të së cilit financohen veprimtaritë komunale. Buxheti paraqet plan vjetor financimi që përbëhet nga një vlerësim vjetor i të ardhurave dhe destinimit të shpenzimeve – pra, për cilat qëllime do të shfrytëzohen të ardhurat e mbledhura. Buxheti dhe raporti vjetor për realizimin e buxhetit duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës.

Buxheti përcakton se çfarë, sa dhe cilat projekte do të realizohen gjatë një viti. Kjo bëhet përmes programeve buxhetore që u përshtaten kompetencave komunale, për shembull programit për veprimtari komunale, për zhvillim lokal ekonomik, për planifikim urbanistik, për kulturë, arsim, mbrojtje sociale dhe të tjera.

Në buxhetin e saj komuna mund të parashikojë program për financim të shoqatave qytetare, ndërsa mbështetjen për projekte konkrete ta përcaktojë me procedura dhe rregulla të brendshme.

Komuna duhet t'i konsultojë qytetaret dhe qytetarët gjatë përcaktimit të prioriteteve për të cilat do të planifikohen dhe shfrytëzohen mjete financiare nga buxheti. Mjetet financiare me të cilat disponon komuna janë të kufizuara dhe për këtë arsye duhet të vendoset se për çka do të shfrytëzohen ato, çka do të jetë prioritet për një bashkësi të caktuar lokale.

Qytetaret dhe qytetarët janë të obliguar t'i paguajnë në kohë detyrimet për të dhënat lokale ndaj komunës, e që janë pjesë e të ardhurave vetanake të financimit. Në këtë mënyrë komuna do të mund të sigurojë mjete të mjaftueshme për të siguruar shërbime komunale. Në të kundërtën, mjetet e pamjaftueshme financiare do të reflektohen në cilësi më të ulët ose pamundësi për të siguruar shërbime të caktuara.

## 7. PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE NË KOMUNA

Për çështje me rëndësi lokale, qytetaret dhe qytetarët mundën në mënyrë të drejtpërdrejtë të marrin pjesë në vendimmarrje, edhe atë përmes: iniciativave qytetare, tubimeve me qytetarë, referendumeve, parashtrësive dhe propozimeve, si dhe tribunave publike, sondazheve dhe propozimeve. Shpenzimet për të mundësuar pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje sigurohen nga buxheti komunal.

### 7.1. Iniciativat qytetare

Me iniciativë qytetare nënkuptohet e drejta e qytetareve dhe qytetarëve t'i propozojnë Këshillit të miratojë një akt të caktuar ose të zgjedhë çështje të caktuar brenda kompetencave të veta. Me akt nënkuptohet statut, program, plan, vendim ose lloje tjera rregulloresh të cilat miratohen në nivel lokal. Nuk mund të parashtrohet iniciativë qytetare për çështje burimesh njerëzore dhe për çështje financiare. Për të gjitha çështjet tjera, Këshilli është i obliguar të shqyrtojë nëse ka mbështetjen e së paku 10% të zgjedhësve të komunës. Këshilli duhet ta mbajë seancën shqyrtuese më së voni 90 ditë nga dita e dorëzimit të iniciativës dhe t'i informojë qytetaret dhe qytetarët për vendimin e tij.

### 7.2. Tubimet e qytetarëve

Në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, tubim qytetarësh mund të thirret për territorin e gjithë komunës ose për territorin e bashkësisë lokale. Tubim qytetarësh mund të thirret:

- me iniciativë të kryetares/kryetarit të komunës;
- me kërkesë të këshillit të komunës; dhe

- me kërkesë të së paku 10% të zgjedhësve të komunës, gjegjësisht të bashkësisë lokale me të cilën ka të bëjë një çështje e caktuar.

Pa marrë parasysh arsyen për thirrjen e një tubimi qytetarësh, administrata komunale është plotësisht përgjegjëse për realizimin dhe organizimin logjistik të procesit, përfshi edhe rrjedhën e informatave ndërmjet qytetarëve dhe organeve komunale (kryetarja/kryetari e/i komunës dhe anëtarët e këshillit komunal). Organet e komunës kanë për detyrë që në afat prej 90 ditësh t'i shqyrtojnë përfundimet nga tubimi i qytetarëve dhe t'i marrin parasysh ato gjatë vendimmarrjes dhe aprovimit të masave lidhur me çështjet përkatëse, si dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e tyre.

### 7.3. Referendumi

Referendumi paraqet mënyrën më legjitime të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetareve dhe qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Ai përfshin çështje që janë pjesë e kompetencave të vetëqeverisjes lokale, edhe atë në sferën e:

- buxhetit;
- financave; dhe
- organizimit të administratës komunale.

Ligji për vetëqeverisje lokale që definon çështjen e zbatimit të referendumit në nivel lokal, parasheh që:

- Këshilli është i detyruar të shpallë referendum me kërkesë të së paku 20% të zgjedhësve në komunë;
- Këshilli mund të shpallë referendum me vetëiniciativë për çështje brenda kompetencave të tij; dhe
- Vendimi i marrë në referendum është i detyrueshëm për Këshillin.

### 7.4. Parashtrësat dhe propozimet

Çdo qytetare ose qytetar ka të drejtë, individualisht ose bashkarisht me të tjerët, të dorëzojë parashtrësra dhe propozime lidhur me punën e organeve të komunës dhe administratës komunale. Kryetarja/kryetari e/i komunës është i obliguar të krijojë kushte për dorëzimin e parashtrësave dhe propozimeve. Më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të parashtrësës, gjegjësisht propozimit, kryetarja/kryetari e/i komunës e ka për detyrë që parashtruesit t'i japë përgjigje me shpjegim. Në rast se pranon parashtrësra dhe propozime që nuk kanë të bëjnë me kompetencat e organeve komunale, kryetarja/kryetari e/i komunës e ka për

detyrë t'ia përcjellë ato organit përkatës kompetent dhe për këtë ta njoftojë parashtruesin.

#### **7.5. Tribunat publike, sondazhet dhe propozimet**

Gjatë hartimit të rregulloreve të komunës, Këshilli gjegjësisht kryetarja/kryetari e/i komunës mundet paraprakisht të organizojë tribuna publike, të organizojë sondazhe ose të kërkojë propozime nga qytetarët.

# Literatura e përdorur

1. **Kodi Zgjedhor** (Propozim-tekst i konsoliduar / version jozyrtar i hartuar nga shërbimi kompetent i KSHZ-së në shkurt të vitit 2020) ["Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19, 42/20 dhe 74/21]; është në dispozicion në vegëzën në vijim: <https://www.sec.mk/izboren-zakonik/>
2. **Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve**, *Doracak për edukimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore komunale, këshillave zgjedhorë dhe këshillave zgjedhorë të KSHZ-së për organizimin e votimit jashtë shtetit, Shkup, viti 2020* (është në dispozicion në këtë link: <https://drive.google.com/file/d/1ZURxnQj6Q3zZv2pXyNqLExMSZS2nBFwI/view>)
3. B. Kordallov dhe të tjerë, *Doracak për votues të rinj*, Misioni i OSBE-së në Shkup dhe Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve Shkup, 2021
4. **Raporti i Misionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR për zgjedhjet lokale në vitin 2017**, është në dispozicion si vijon: <https://www.osce.org/files/f/documents/9/4/372751.pdf>
5. Jane Dimeski dhe autorë të tjerë, *Doracak për zgjedhje lokale në vitin 2017*, Fondacioni Konrad Adenauer dhe Instituti për Demokraci "Societas Civilis", Shkup, 2017
6. **Civil, Gjithçka që deshët të dini për zgjedhjet**, Shkup, 2019
7. Instituti Parlamentar, *Sistemi zgjedhor proporcional në një njësi zgjedhore kundrejt sistemit zgjedhor proporcional në më shumë njësi zgjedhore*, Shkup, 2017
8. I. Jovanov, *Për modelet zgjedhore*, Shkup, 2015
9. Dushica Perishiç dhe autorë të tjerë, *Doracak për kryetarët e komunave dhe këshilltarët për kompetencat e vetëqeverisjes lokale*, Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale, Shkup, 2017
10. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*
11. *Ligji për vetëqeverisje lokale*, Gazeta Zyrtare nr. 5/2002
12. *Ligji për Qytetin e Shkupit*, Gazeta Zyrtare nr. 55/2004,
13. *Ligji për financimin e njërive të vetëqeverisjes lokale*, Gazeta Zyrtare nr.61/2004,

14. *Ligji për organizimin territorial të njërive të vetëqeverisjes lokale*, Gazeta Zyrtare nr. 55/2004
15. *Ligji për bashkëpunim ndërkomunal*, Gazeta Zyrtare nr. 79/2009.
16. Misioni i OSBE-së në Shkup "*Doracak për promovimin e parimeve të qeverisjes demokratike në këshillat e njërive të vetëqeverisjes lokale*", 2019, është në dispozicion si vijon: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/1/413075.pdf>
17. Fondacioni Konrad Adenauer "*Koncepte dhe parime të qeverisjes demokratike dhe llogaridhënie*", 2011, është në dispozicion si vijon: [https://www.kas.de/c/document\\_library/get\\_file?uuid=56a283ae-50ff-0c9b-7179-954d05e0aa19&groupId=252038](https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=56a283ae-50ff-0c9b-7179-954d05e0aa19&groupId=252038)

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352:324(497.7)(035)

ÇFARË është pushteti lok dhe si e zgjedhim atë [Електронски извор] :

doracak për zgjedhje lokale i dedikuar për votues / [autore dhe autorë Nina Shulloviç-Cvetkovska ... [и др.] ; përktheu nga maqedonishtja në shqip Fatos Kica]. - Shkup : Komisioni Shtetëror Zgjedhor i Republikës së Maqedonisë së Veriut : Misioni i OSBE-së në Shkup, 2021

Начин на пристапување (URL): <https://www.sec.mk>. - Начин на пристапување

(URL): <https://www.osce.org>. - Превод на делото: Што е локална власт и како ја избираме : прирачник за локални избори наменет за гласачи. - Текст во PDF формат, содржи 36 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 10.09.2021. - Фусноти кон текстот. - Други автори: Маја Лазарова, Dushko Todoroski (OSBE), Admir Shabani, Ljupka Guguçevska-Filiposka (KSZ). - Библиографија: стр. 35-36

ISBN 978-608-4949-05-3 (KSZ)

ISBN 978-608-4788-71-3 (OSBE)

1. Shulloviç-Cvetkovska, Nina [автор] 2. L Lazarova, Maja [автор] 3.

Todoroski, Dushko [автор] 4. Shabani, Admir [автор] 5.

Guguçevska-Filiposka, Ljupka [автор]

а) Локална самоуправа -- Изборен процес -- Македонија -- Прирачници

COBISS.MK-ID 54906885